

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mirëdita të gjithëve! Të nderuar Këshilltarë, Kryetar i Bashkisë, kam kënaqësinë t'ju uroj një punë të mbarë në sallën e re të Këshillit Bashkiak Elbasan. Kjo sallë është me të gjithë pasisjet e duhura dhe me këtë ambjent funksional do të jetë si simbol i zhvillimit të mbledhjeve të bashkisë, me më shumë transparencë dhe më shumë efektivitet nëpërmjet dialogut të hapur dhe diskutimeve të singerta. Ky investim që është bërë nuk është thjesht një përmirsim fizik i sallës por na krijon mundësinë dhe hapësira për të zhvilluar mbledhjet e këshillit që ato ti shërbejnë më mirë debatit dhe vendimarrjes së qytetarve të Elbasanit. Me këtë rast unë dua të falënderoj të gjithë ata që kontribuan për realizimin e kësaj projekti funksional. Unë si drejtues i Këshillit Bashkiak kam besim të plotë dhe këtë e shpreh edhe në emrin tuaj se kjo sallë do të jetë vendi i pluralizmit, i dialogut, i bashkëpunimit të këshilltarëve pavarësisht se kujt force politike i përkasin. Me synimin që të garantojmë vendimarrje të ligjshme, të përmirsojmë marrëdhënien midis këshillit dhe ekzekutivit, ti garantojmë të drejtën publikut për ti informuar me punët e bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak, të garantojmë transparencën e qeverisjes lokale, të garantojmë dokumentimin dhe administrimin e plotë të punëve të Këshillit Bashkiak. Suksese dhe urime të gjithëve!

Kalojmë tek fillimi i mbledhjes së muajit Gusht. Ka disa probleme akoma, mund ta shpjegoje dhe Sokoli si sekretar, dhe këtë rradhë apelimi do të jetë me emra. Ftoj sekretarin të bëjë apelin.

### **Sokol Sinani-Sekretar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se erdhët në sallën e re!

Z. Sokol Sinani bën apelin, prezent në sallë janë 42 antarë. Meqënëse kësaj rradhe kemi votim elektronik duhet të kemi pak kujdes, e kemi aparatën përpara, kemi

opsionet pro abstenim dhe kundër tek aparati. Kur të hidhet në votim duhet të votojmë tek aparati dhe del tek ekranet kryesore votimi. Ju faleminderit të gjithëve!

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Meqë kuorumi është, e deklaroj mbledhjen të hapur. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Përshëndetje, ta gëzoni dhe ambjentin e ri. Çdo këshilltar do ketë kartën e vet dhe paisja do të lexojë kartën individuale të gjithë secilit në mënyrë që të shohi dhe prezencën dhe prandaj prezenca sot u bë në mënyrë nominale. I vetmi ndryshim është që do vendoset karta dhe do votohet. Në momentin që fut kartën ndizet aparatura.

### **Pika e parë e rendit të ditës**

#### ***1. Miratimi i rendit të ditës.***

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(Y. Balliu; A. Kana; E. Murataj; A. Murati)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

#### ***2. Miratimi I proçesverbalit të muajit Korrik datë 29.07.2025***

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro,- kundër, 2 abstënim, miraton sa më sipër.

(D.Çepa;E.Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

#### Pika 3 e rendit të ditës

#### **3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Korrik 2025**

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj;E.Muzhaqi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 3.1 e rendit të ditës**

#### ***3.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Korrik 2025***

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro,- kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj; E. Muzhaqi; D. Madhi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

***4. Për miratimin e projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt I kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)***

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Është një hap I rëndësishëm për pushtetin vendor, jo vetëm për Bashkinë e Elbasanit po për të gjithë Bashkitë e Shqipërisë pasi një nga nevojat kryesore që kemi me integrimin në Bashkimin Europian dhe me hapjen e negociatave lind domosdoshmëria për një administratë më shumë të trajnuar, më shumë profesionale dhe deri sot instrumenti I vetëm që ne kishim për trajnimin e administratës ishte ASPA. Sot të gjitha bashkitë do kenë një institucion të tyre ku do të trajnojnë punonjësit e tyre. Jo vetëm rolet drejtuese por edhe specialist të ndryshëm të drejtorive të varësisë ose agjensive të bashkisë do të kenë një koherencë më të mirë me institucionet e tjera apo me kolegët e tyre për të ndarë problematikat, për të zgjedhur zgjidhjet të përbashkëta dhe për të patur një zë për ndryshimet. Arsyeja kryesore ka ardhur pikërisht nga nevoja që kemi patur ne si drejtues për të patur një administratë më të trajnuar. Është një hap I mirë, një pjesë e buxhetit do të sihurohet nga buxheti I shtetit dhe nga donatorë të ndryshëm dhe 50 % të jetë nga vetë bashkitë. Është një instrument I mirë, ashtu siç e kanë shumë vende të Bashkimit Europian për trajnimin e Administratës së Pushtetit Vendor, është për Pushtetin Vendor pikërisht për Bashkitë e vendit dhe Këshillat e Qarkut.

### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ky është instrument që plotëson gjithë pjesën dokumentare të integritit në Bashkimin Europian dhe në fakt duhet të ishte një lajm i mirë. Po prej Bashkisë Elbasanit e cila e ka dhënë provën e saj dhe me lëvizjen e fundit ku riciklon njerëz me performancë jo të mirë, bie poshtë kur vijnë përpara nesh të tilla nisma, që në letra janë pozitive. Në një vend si Elbasani që riciklon punonjës të pa aftë dhe ku e vetmja pishinë kërkohet të bëhet pallat, unë mendoj që është mirë të fillojmë të mendojmë të mbledhim limona.

### **Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush na garanton ne që personi që do trajnohet nuk do ta heqin nga puna? Ky është problem i madh.

### **Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë e përshëndes këtë nismë pavarësisht se edhe me kolegët parafolës kemi pika të përbashkëta dhe unë nuk dua të jem përsëritëse. Në disa nga nenet e projekt marrëveshjes sanksionohet mënyra se si bashkia do të jetë pjesëmarrëse në financimin e këtij projekti. Askund nuk është e shkruar se cila do jetë kostoja e Bashkisë Elbasan që të paktën të thoshte se do jetë rreth 50% e kostove të përgjithshme të financimit përse i përket trajnimit të punonjësve të vet. Do doja të dija nëse keni informacion më të hollësishëm sesa do ti kushtojë Bashkisë Elbasan pjesëmarrja në këtë projekt.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Është bërë llogaritja, e kemi miratuar në buxhet. Është futur që në Dhjetor, është futur në buxhetin e këtij viti, parashikohen çdo vit. Është një e ardhur e cila kostot e akademisë përpjestohen, 50% e kostove ndërmjet të gjitha Bashkive të Republikës së Shqipërisë, në bazë të madhësisë së administratës. Nuk është një vlerë fikse pasi kostot mund të rriten ose mund të ulen në bazë të donacioneve që vijnë ose të projekteve që aplikon vetë akademia por përpjestimisht do të jetë 50% e vlerës e shpërndarë në të gjitha bashkitë e vendit sipas madhësisë së tyre.

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përshëndetje, ju uroj të gjithëve një sesion të mbarë të punës në dobi të qytetit të Elbasanit sepse ne jemi të zgjedhurit vendor dhe shpresoj nga këtu të burojnë vendime të drejta dhe transparente për publikun. Kisha disa pyetje në lidhje me këtë nismë. Ne kemi një administratë të pa trajnuar dhe jo të gatshme që ne të bashkohemi me Bashkimin European. Unë kam një shqetësim përse I përket shpenzimeve, se që do të ngrihen shpenzimet kjo është e kuptueshme. Nuk jam dakort që të trajnohen 1482 punonjës që ka aktualisht bashkia. Meqë po shkojmë drejt Europës duhet që të kalojmë drejt një administrate profesionale dhe të reduktuar në numra. Mos I shpenzojmë paratë për paga, të trajnojmë të gjithë punonjësit kur në fakt nuk na dhen kaq prandaj duhet bërë një studim një herë që sa punonjës realisht duhen në çdo sektor apo pozicion, a janë të nevojshme sepse me çfarë dëgjojmë lart e poshtë bëhen abuzime me vende punonjësish të cilët tregojnë që administrata është e fryrë. Për të bërë një administratë efikente që të shkojmë drejt Bashkimit European nuk është çështje vetëm e Talgës. Unë jam dakort që të trajnohen por vetëm ata të cilët kanë nevojë dhe janë vërtetë njerëz që janë të aftë dhe e meritojnë pozicionin e punës që kanë në Bashkinë e Elbasanit. Ju faleminderit!

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Mu duk si koment më tepër sesa si pyetje. Nuk ke 1482 administratë por ke futur brenda aty pastrueset e shkollave, edukatorët, punëtorët e gjelbërimit, punonjësit për mirmbajtjen e qytetit. Akademia është për administratën publike. I kemi kërkuar që të hapen edhe për pozicionet teknike, për shërbime të ndryshme që ofron Bashkia, momentalisht ato shërbime ne i kryejmë me trajnimet që bëjmë tek shkolla e formimit profesional. Administrata e Bashkisë Elbasanit është tek mesatarja e numrit të bashkive të tjera dhe nuk është e vërtetë që ke një fryrje apo ka një mbiorganizim të strukturave të bashkisë pra kjo nuk është e vërtetë, është një konstatim që bëhet për organizimin e bashkisë për pozicione të caktuara sa efikase janë. Trajnimet do të shërbejnë për të gjithë administratën e bashkisë, janë të detyrueshme sot me statusin e nenpunësit civil, në kontratat e punës që punëmarrësi pra ne të trajnojmë administratën tonë në mënyrë të vazhdueshme. Për kuadrin ligjor që ndryshon, për gjithë të rejtat që sjell zhvillimi ekonomik I qytetit dhe I bashkisë. E kemi dhe ne detyrim ligjor që punonjësit tonë të trajnohen. Duke

mos parë efikasitet tek struktura tjetër që ishte deri më sot ASPA që bënte vetëm trajnime për shërbimin civil dhe për të gjithë administratën shtetërore fut këtu pushtetin qendror dhe pushtetin local. Kjo akademi është shumë e domosdoshme. Kur 70% e negociatave është në pushtetet vendor prandaj është shumë e domosdoshme të kemi një administratë të trajnuar. Nuk ka një nenpunës civil I cili nuk ka marrë trajnimin përkatës dhe nuk është e vërtetë aq administrate e bashkisë nuk paska marrë trajnimin më përpara.

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nga kolegët e mi shumë herë është bërë kërkesa në Bashkinë e Elbasanit që të na sillet organika e ndarë në sektorë dhe në role me emra dhe me sektorë përkatës . Kërkoj ndjesë për atë numrin që thashë 1482 punonjës, atëherë është një kërkesë e imja që të na sillet dhe të na vihet në dispozicion organika që ka Bashkia Elbasan dhe sa është numri I punonjësve për të bërë një përlllogaritje se sa është kostoja që do të përballojë bashkia te ky projekt.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro,3 kundër, 6 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana;E.Murataj;E.Muzhaqi)

(Y.Balliu;D.Çepa;B.Çopja;R.Mita;A.Murati;Z.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**5. Për një ndryshim në VKB Nr.43 Dt 30.04.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPU”**

### **Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Realisht për këtë vendim, bashkia ka blerë 2 makina të reja, është një kamion 3.5 ton me vinç edhe një fuoristradë me karroceri. Në bazë të përvojës që bëhet vazhdimisht të praktikës është bërë dhe matja e normativës së karburantit dhe është një praktik rutinë që miratohet në Këshill Bashkiak. Njëra harxhon 13 litra/orë dhe tjetra 10 litra/orë.

### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kam një pyetje, kjo matja e normativës normalisht kur bëni prokurim, enti prokurues cakton dhe disa të dhëna. A përputhen këto të dhëna me ato që keni kërkuar ju për të blerë mjet, me këtë normativën a përputhen?

### **Ermira Jaupi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Erion po këto formulat e tua pse duhet ti zbatojnë të gjithë

### **Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kur planifikohet buxheti në çdo drejtori ka një normë të caktuar për shpenzimet e karburantit, në momentin kur ti e tejkalon këtë fillon lëviz zërat e buxhetit. Ku është norma e amortizimit që të verifikohet?

**Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju lutem vazhdoni flisni me rradhë. Kush është pro?

Këshilli Bashkiak me 25 vota pro, 6 kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

(Y.Balliu; D.Madhi; A.Meçja; E.Murataj; A.Murati; E.Muzhaqi)

(V.Balliu; L.Hasa; A.Kana; R.Mita; Z.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

#### ***6. Relacion për Planin vendor të veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028***

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Dua të them diçka për të gjitha planet, është një gjë pozitive që sot kemi 3 materiale të tilla ku është kodi etikës, plani integritetit, plani vendor I arsimit dhe plani I mbrojtjes sociale. Kemi patur një qasje që të vazhdojmë me planifikimin dhe të vazhdojmë me zbatimin. Për të gjitha kto plane është bërë konsultimi publik, është marrë një grup ekspertësh përkatës nga bashkia por edhe ekspertë të jashtëm. Kemi marrë për bazë planet ekzistuese pra ato që kanë qenë në fuqi dhe është përmirësuar duke kaluar në faza të tjera dhe në plane të reja të cilat propozohen sot për miratim. Ky është edhe një detyrim në fakt, duhet ti kemi kto planet, planet e veprimit pasi në bazë të kësaj do bëhen edhe planifikimet buxhetore, do bëhen për vitet e ardhshme, do të bëhen dhe politikat që ne kemi, politikat sociale, politikat për arsimin. Një sërë zhvillimesh kanë këto plane, është edhe momenti tani në fakt. Të gjitha bashkitë kanë një fond performance, kanë një bonus performance I cili do të shpërndahet në fund të vitit. Fondi I performancës ose një grant I paspecifikuar do të bëhet edhe mbas performancës që ka çdo bashki dhe të akteve që ato miratojnë rregullatore. Për çështjet specifike do të flasin përfaqësuesit përkatës.

### **Eltiona Kolla-Përfaqësuese e Administratës**

Plani 2024-2027 u rikonceptua, për shkak se tek ai plan që ne kishim, nuk ishin të përfshira masat e komunitetit Rom dhe Egjiptian. Kjo masë nuk ishte përfshirë deri më tani, sepse në periudhën 2019-2022 të gjithë sëbashku kemi bërë planin vendor

të pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe e kemi miratuar së bashku në Këshill Bashkiak.

Por, duke qenë se kjo periudhë përkoi me pandeminë e kovidit në vitin 2019, dhe duke diskutuar edhe me organizatat, shoqëritë civile dhe komunitetin, ne vendosëm që këtë plan ta kryejmë veçmas, dhe jo sëbashku me planin e përfshirjes.

Stafi ka punuar bashkë me ekspertë të fushës, si dhe me persona të cilët i përkasin komunitetit Rom Egjiptian, që kanë kapacitete, dhe i janë ofruar bashkisë si dhe kanë dhënë dakortësinë për të punuar së bashku. Aktualisht po e kthejmë planin në formë shtojce, duke futur një pjesë të mirë të masave për ta integruar dhe për ta gjithëpërfshirë këtë komunitet në shoqëri.

Është një komunitet që ka specifika të veçanta, ndaj ka patur nevojë për ndihmë dhe mbështetje të posaçme. Prandaj grupi I punës u mbledh dhe u përpoqëm që të bëjmë një plan të mire.

### **Artan Kana- Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ktë çështje e diskutuam edhe në komision kur ishim, po e ngre edhe këtu në këshill për ata të cilët nuk ishin ta dëgjojnë dhe ta kuptojnë se për çfarë e ngrita si shqetësim. Unë jam dakort që shtresat në nevojë të trajtohen, madje jam pro që të trajtohen të gjithë njëlloj pavarësisht ngjyrës, racës apo minoriteteve. Nuk më pëlqen shtesë specifike për pakicat Rome dhe Egjiptiane dhe kam dhe një pyetje për zonjën që me këtë shtesë specifike për pakicat Rome dhe Egjiptiane, atyre i shtohen më shumë të ardhura në raport me shtresat e tjera në nevojë? A kanë ata më shumë të drejta apo përfitojnë akses më të lehtë dhe i plotësojnë ato kriteret më lehtësisht seç i plotësojnë shtresat e tjera? Sepse kto shtesat specifike për pakicat se spo e përmend emrin se dikush e merr me notacion negativ, nuk e kam problemin. E kam problemin tek shtesa specifike se nesër do na dali shtesa specifike për një komunitet tjetër që do pretendojë që është i diskriminuar në qytetin e Elbasanit apo në Shqipëri. Unë e kam shqetësim këtë për vendin tim. Mos e ndani këtë popull, boll jemi ndarë kaq vite e shekuj në Toskë, Gegë, Veri, Jug, qytetarë, katundarë. Mos i ndani njerëzit me shtesa specifike. Nëse e meritojnë si ky komunitet që po flasim apo edhe komunitetet e tjera të ndihmoen, ta kenë lehtësin dhe aksesin në bashki apo në çdo institucion si ky komunitet specifik që po shtoni.

Bëni një plan të përgjithshëm për të ndihmuar shtresat në nevojë pavarësisht ngjyrës, gjuhës apo pretendimit të tyre se janë një minoritet i caktuar. Republika e Shqipërisë është shtet autonom, i pavarur, i shpallur prej njëqind e ca vjetësh dhe mos e ndani. Sot i hapni derën një shtese specifike, nesër i hapni një territori të caktuar.

### **Eltiona Kolla-Përfaqësuese e Administratës**

Paraprakisht unë jua thashë që kemi patur një plan vendor specifik për pakicat Rome dhe Egjiptiane. Ky është detyrim ligjor; nuk është kërkesë e jona, por një detyrim ligjor. Plani i mëparshëm nuk u realizua siç duhej, për shkak të periudhës së kovidit. Edhe masat e vendosura nuk u zbatuan, sepse shuma sa ishin vendosur bashkisë, ndërkohë që ka edhe institucionet të tjera kompetente që duhej të merrnin masa dhe ti zbatonin. Pra kishim më shumë objektiva dhe zbatime ne si bashki sesa institucionet e tjera. Në raportimet që bëme në ministri, nuk dolëm ashtu siç duhej. Dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me ne si bashki, por ka të bëjë me ligjin në tërësi. Ne po përpiqemi që ta bëjmë, ta përfshijmë por pavarësisht se po bëjmë përfshirjen e pakicave Rome Egjiptiane në këtë plan, kjo nuk do të thotë që ne jemi marrë vetëm me këtë pjesë të matricës sepse kemi update-uar të dhënat qoftë për përfituesit e ndihmës ekonomike, qoftë me shërbimet që ofrohen tani në Bashkinë e Elbasanit pra jemi drejt hartëzimit të shërbimeve sociale dhe kemi detyrim të bëjmë identifikim të nevojave dhe të ofrojmë shërbime cilësore për këdo që i përket komunitetit të Elbasanit.

### **Artan Kana- Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Çfarë përfitojnë këto shtresa?

### **Eltiona Kolla-Përfaqësuese e Administratës**

Çdo shërbim të mundshëm që ofron Bashkia Elbasanit, ky komunitet dhe të gjithë target grupet në nevojë që kanë patur nevoja, i kanë marrë dhe do ti marrin gjithmonë sepse ne për këtë jemi ktu. Janë 7 fusha kryesore që ndërlidhen. Ne mund të ulemi më gjerësisht bashkë e të flasim për specifika që të kuptohemi më mirë. Patjetër që do ti shtojë bonus si bashkisë si komunitetit.

### **Artan Kana- Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ja tejkalon një nevojtar tjetër që ka po të njëjtin hall dhe mund të jetë më shumë nevojtar, unë spo them se e keni fajin ju e ka ligji. Po e ngre si shqetësim se është e rrezikshme kjo shtesë specifike se është padrejtësi që I bëhet pjesës tjetër që nuk I përket kësaj kategorie

### **Eltiona Kolla-Përfaqësuese e Administratës**

Nëse do kishim këtu një person që do ti përkiste atij komuniteti mbase sdo e kishte mendimin si ju.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Fjala për Znj. Hasa

### **Lumturi Hasa- Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Doja të bëja një pyetje që a mund të përfitoj edhe unë ndonjë shtesë specifike meqënëse vij si komuniteti çam?

Atëherë unë mendoj, jam shumë dakort për ti ardhur në ndihmë çdo lloj komuniteti sepse para Zotit jemi të gjithë njëloj dhe nuk është e thënë ti vendosim kto terma. Kryeministri Rama ka vendosur Ministre dhe Zëvendës Ministre nga Komuniteti Rom. Unë mendoj që kjo është një diskriminim total për komunitetin rom apo për këdo qoftë. Në momentin që ne I vendosim kto shtesa specifike, ne I lejmë njerëzit të diskriminuar. Nëse duhet të futesh në bashki dhe duhet të shihesh nga ngjyra, unë mendoj që nëse I ka të gjitha aftësitë e duhura, mund ti kalojë edhe ato që janë pa diploma ktu në bashki. Kushdo dhe kurdo, nëse është I aftë le të punojë, nëse është në nevojë le ta marri. Kto shtesat janë diskriminim total.

### **Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Qëndrojmë tek faktet dhe tek dokumentacionet. Diskutimin për relacionin e bëm edhe tek komisionet. Unë kërkoja një informacion që mesa mu dha informacion në komision është që detyrimi ligjor I Bashkisë Elbasan është për hartimin e një plani vendor të veprimit për mbrojtjen sociale. Kaq, jo me shtesa dhe me prapashtesa. Të paktën në komision na e konfirmuat këtë. E dyta, juridikisht pyetëm juristin përfaqësuesin e bashkisë se si përcaktohen pakicat kombëtare juridikisht Rome dhe Egjiptiane. Sinqerisht jua them se nuk kishte përgjigje sepse nuk ka një përcaktim

të saktë për kto dy pakica. Kto janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë, që janë nënshtruar Shqipëtarë dhe me kombësi Shqiptare. Juristi nuk diti ti japë përgjigje sepse nuk e ka përcaktuar juridikisht për kto dy pakica. Shikoj që ka një lloj reagimi, çuditen njerëzit pse e diskutojmë këtë plan ndërkohë që parafolsit e thanë që jemi dakort me planet zhvilluese të çdo lloj zhvillimi sidomos me planet e mbrojtjes sociale por ama edhe njëherë tjetër në këtë këshill të nderuar është përdorur kjo ndasi dhe edhe hera të tjera kemi pas reagime nga disa nga këshilltarë. Nuk na pëlqejnë, janë axhenda të cilat nuk kemi ne pse ti hyjmë ktyre valleve, janë axhenda të zeza që na çojnë në kto ndasi ndërkohë që ska pse...në një plan...o këshilltarë ju ngreni dorën thoni pse...lexoni letrat thotë vendosi miratimin e planit të mbrojtjes sociale 2025-2028. Kaq vendos ky këshill, jo pakica, jo shumica, kaq vendos ky këshill. Pra shtojca dhe shtesat specifike nuk janë të qarta shumë për ne.

### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kisha një pyetje për zonjën dhe një koment të vogël. E para unë mendoj që çdo lloj plani që I shërben qoftë pakicave, sidomos në një qytet si Elbasani që jemi të gjithë pakicë kur vjen puna tek mbështetja, është I dobishëm. Pyetja që kam unë për juve është e thjeshtë: A është implementuar ky plan, asistenca ndaj komuniteteve, ndaj atyre që janë në nevojë qoftë e përdorjes së këtyre sistemeve të reja online për pronësinë sepse një pjesë e madhe e ktyre komuniteteve që ju përmendni e kanë problem thelbësor qoftë aplikimin për një certifikatë pronësie apo të një kartelet, një harte pasurie apo të aplikimit të çfarë do lloj tjetër në kto platformat e reja online. Janë parashikuar në këtë lloj plani? Duke qen se bashkia ka bërë edhe këtë zyrën.

### **Eltiona Kolla-Përfaqësuese e Administratës**

Bashkia gjithmonë ka qenë suport dhe mbështetje për çdo kërkesë të qytetarëve. Edhe tek plani ne nuk e kemi ndarë se ne nuk e parashikojmë dot çfarë do ndodhi si do vijë problematika por duke bërë hartëzimin e shërbimeve sociale, duke I identifikuar nevojat, patjetër që I kemi ndihmuar dhe do I ndihmojmë. Në këtë gjë e bëjmë çdo ditë në zyrat tona, nëse dikush ka nevojë patjetër që e suportojmë, e mbështesim si për proces aplikimi madje I kemi shoqëruar dhe vetë individët kur kanë nevoja të tilla. Prandaj po e bëjmë rishikimin çdo vit.

### **Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Demokracia mbështetet në respektimin e pakicës, qoftë kjo pakicë partiake apo sociale. Nuk është vendi këtu të diskutojmë se po I diskriminojmë ato, nuk I respektojmë. Përkundrazi është Demokraci, duhet ti respektojmë sepse edhe vet e dijmë çfarë diferencash kemi. Ka diferenca kulturele, arsimore, shumë diferenca që respektohen. Nga ana tjetër jo vetëm këtu në Shqipëri por në gjithë Europën Romët respektohen dhe favorizohen. Nuk është diskriminim që respektohet pakicë përkundrazi është demokraci. Për mendimin tim nuk duhet ta drejtojmë diskutimin drejt kësaj pike, është tjetër gjë në qoftë se ne nuk I kemi respektuar si duhet qoftë Romët qoftë shtresa të tjera që janë në nevojë. Shtresat që janë në nevojë janë shtresat e pakicës, që ne duhet ti respektojmë, ti ndihmojmë. Ky është shteti social, kjo është demokracia. Kaq kisha për të thënë, faleminderit!

### **Hektor Çiftja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Sinqerisht të gjithë diskutimet e opozitës dhe të mazhorancës kishin vlerë. Desha të theksoj vetëm një element që në planin social të mbrojtjes sociale, vendosja me vëmendje të veçantë e komuniteteve të caktuara së pari është diskriminim pozitiv, së dyti është një kërkesë e Këshillit të Europës dhe e legjislacionit. Së treti pavarësisht se unë mendoj si kolegët e opozitës që ne të gjithë jemi vulnerabël por në të gjithë konsultimet publike që janë bërë shtresa vulnerabël që është përcaktuar këtu është vërtet më vulnerabël se shtresat e tjera. I referohemi arsimit, banesave apo elementëve të tjerë. Plani I veprimit nuk ndryshon asgjë vetëm se ndryshon vëmendjen që ky këshill ka për këtë lloj shtrese. Ky është diskriminim pozitiv.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Plani që ne po miratojmë sot, që kemi parashtruar për tu miratuar në këshill, plani vendor I veprimit për mbrojtjen sociale është një plan I përsëritur I cili ne në strategji të ndryshme në fakt kemi vepruar gjatë këtyre viteve. Po bëhet një temë në fakt po bëhet folklorizëm siç e shoh unë për pjesën e komunitetit Rom apo Egjiptian apo shtresave të ndryshme të cilat janë në nevojë dhe kanë nevojë për mbështetjen e bashkisë dhe për mbështetjen e shoqërisë në përgjithsi dhe nuk më vjen mirë në fakt që bëhen këto komente. Është mëse e verifikuar tashmë dhe në bazë të projekteve tona dhe në bazë të strategjive tona, është bërë një punë e mirë deri tani në planet e kaluara me strategji. Dua tju rikthej dhe njëherë vëmendjen tek

banesat sociale që ne kemi aplikuar dhe kemi rikonstruktuar totalisht dhe pjesërisht në Rrapishtë. Dua tju them se janë bërë në bazë të ktyre planeve. Dua tju rikujtoj disa rrugë që kemi bërë, kanalizimi I ujrave të zeza, një sërë projektesh që janë bërë për të lehtësuar të gjithë pjesën ekonomike por edhe integrimin sa më të mirë të komunitetit Rom, Egjiptian dhe të shtresave të ndryshme në nevojë. Ka një prioritet që është e vërtetë për shtresat në nevojë dhe për gratë e dhunuara, për kryefamiljaret nëna të vetme, për komunitetin Rom dhe Egjiptian, të cilët kanë nevojë për një mbështetje më të madhe sesa të tjerët. Për integrimin e tyre në punë kemi aplikuar projekte të ndryshme në bazë të këtyre strategjive dhe në bazë të ktyre planeve vendore të veprimit për punësimin e tyre sezonal apo të përhershëm. I kemi patur dhe I kemi në fokusin tonë kryesor si Bashki e Elbasanit. Ktë jua siguroj. Plani vendor që ne po propozojmë sot për tu miratuar është një plan që është bërë mbas një experience të gjatë që ne kemi, mbas një sërë projektesh të aplikuara me sukses dhe jemi të bindur që ky plan me implementimin e tij do të sjelli një gjithpërfshirje më të madhe të komuniteteve të ndryshme që ne kemi në Elbasan, të shtresave në nevojë dhe atyre që kanë më shumë nevojë për ndihmë të shtetit. Asnjë nuk e ceku, vetëm planet që kemi aplikuar deri tani kanë patur një ulje të ndjeshme të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe të punësimit të tyre, në bashkëpunim të mirë me zyrën e punës, me projektet, me donatorë të ndryshëm për punësimet sezonale, të përhershme, dhënien e profesioneve të shtresave në nevojë por edhe të komuniteteve të cilat janë më të marxhinalizuara. Unë do ju ftoja të gjithëve ta votonit këtë plan pasi është një plan I cili I shërben shtresave që janë më shumë në nevojë. Shtresa të cilat kanë nevojë për mbështetje, për vëmendje të veçantë nga shteti dhe nga komuniteti për tu integruar. Mos harroni një gjë, jetojmë të gjithë në një qytet, I kemi në banesat tona ngjitur, dhe do ju ftoja të gjithëve që ta votonit këtë plan të mbrojtjes sociale dhe të mbështetjes zbatimin e këtij plani. Faleminderit!

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, 4 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(Y.Balliu; A.Kana; E.Murataj; E.Muzhaqi)

(A.Meçja; R.Mita; A.Murati; Z.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

#### Pika 7 e rendit të ditës

*7. Për miratimin paraprak të Planit të Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore “Kushë 1 dhe Zaranikë”*

### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atë ditë u shpjegua tek komisioni, nuk e di a keni ndonjë pyetje prapë?

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

(A. Meçja)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

#### ***8. Për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Elbasan 2025-2028***

#### **Lorena Haxhiymeri-Përfaqësuese e Administratës**

Të nderuar këshilltarë Plani I Integritetit është një dokument i cili është bashkëkrijuar në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse, jo vetëm me grupet e punës të përfaqsuara nga administrata e bashkisë por edhe nga shoqëritë civile me anë të forumit të qeverisjes së hapur gjithashtu edhe me antarë të Këshillit Bashkiak nga komisioni I çështjeve ligjore. Plani Integritetit është bazuar dhe hartuar në bazë të strategjisë kombëtare kundër korrupsionit 2024-2030. Në saj të angazhimit të Bashkisë Elbasanit në kuadër të qeverisjes së hapur dhe zbatimi VKM 241 dhe 2018. Sëbashku me planin e Integritetit gjithashtu është rishikuar edhe kodi I sjelljes dhe lutem që të bëhet miratimi I Planit të Integritetit dhe shfuqizimi I Kodit të Sjelljes 2019 i cili është përshtatur me ligje të reja në fuqi dhe të bëhet miratimi I Kodit të Sjelljes 2025.

#### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Së pari është gjë e mirë që ju keni një plan, për të patur integritet si institucion. Kjo është gjëja e parë pozitive. Të kesh një plan, të kesh integritet është gjë e mirë edhe pse nuk e ke sot. Përsa i përket kodit të sjelljes ti the që amendimet përkatëse bashkë me kodin e ri të sjelljes që ke sjellur janë të bazuara në ligj. Unë e lexova mirë dhe besoj që kam ekspertizën e nevojshme juridike për të gjetur disa gjëra që ishin absurde aty. Së pari Bashkia Elbasan funksionon si institucion në bazë të ligjit për qeverisjen vendore. Kjo është alfa e institucionit. Ajo që kishit bërë juve

tek plani vijues që do të vijë, që kërkonit të shfuqizonit planin e mëparshëm të etikës, është e njëjta gjë me atë që po ndodh në nivel qendror me kodin e ri penal. Ju keni marrë attribute të një institucioni që nuk ju takon, për të cilën nuk keni as ekspertizën, nuk keni as burimet njerëzore për të patur atë formim që ti jepni atij plani efikasitetin e duhur dhe zbatueshmërinë e duhur dhe kur vijmë tek etika unë besoj që plani etikë do të bazohet mbi praktikat e rëndësishme dhe të mira të një institucioni. Më thoni ju mua çfarë etike ka Bashkia Elbasan kur vjen te dera dhe të mbyllet dera, jo vetëm qytetarëve nga jashtë po I mbyllet edhe punonjësve. Në orën 8 këtu ka ndodhur që janë hequr dhe kartat, I ka mbajtur kartën drejtori dhe kjo nuk është etike. Plan etike do të thotë që ti mbi çedimet që ke patur në eksperiencën tënde duke futur ktu edhe ekspertizën e ligjeve ose paragrafeve që do të vijnë për shkak të marrveshjeve ndërkombëtare që ti synon integrimin në Bashkimin European. Nxirr një produkt të rëndësishëm. Vetëm letra do bëjmë ne? A keni juve sot një raport mbi planin etikë që keni ezauruar deri sot, qoftë në raport me qytetarët a qoftë në raport me veten. Faleminderit juve që keni një plan, që keni etikë nga sot e mbrapa!

### **Lutfi Lala-Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ka ndonjë tjetër ndonjë sygjërim?Jo, hapet votimi.

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro,1 kundër, 9 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj)

(Y.Balliu;D.Çepa;B.Çopja;L.Hasa;A.Kana;D.Madhi;A.Meçja;R.Mita;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Dua të tërheq vëmendjen për Anëtarët e Këshillit Bashkiak . E quaj jo etike drejtimin e përfaqësuesve të administratës nga Anëtarët e Këshillit Bashkiak me disa fjalë jo etike, do të kërkoja herë tjetër mos përsëriten dhe këto sjellje mos ti kemi të paktën në administratën tonë.

### **PROÇESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

## **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

### **Pika 10 e rendit të ditës**

#### ***10. Për miratimin e “Plani Vendor I Arsimit Parauniversitar, në Bashkinë Elbasan”***

## **Afrim Qosja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përshëndetje të nderuar këshilltarë, kemi përpara një projek-tvendim të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë për Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar për vitet 2025-2028 të Bashkisë Elbasan. Ky plan është hartuar në përputhje me ligjin 139/2015 për vetqeverisjen vendore, ligjin 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë si dhe në bazë të kornizës ligjore për decentralizimin dhe qeverisjen vendore. Plani ka një parashtrim të situatës aktuale të arsimit parauniversitar në përgjithësi, qëllimet e këtij plani si dhe situata financiare që parashtrohet të miratohet në planin afatmesëm të Bashkisë Elbasan për vitin 2026-2028. Ka mekanizma të qartë monitorimi llogaridhënie dhe impakti është i tillë që do të sigurojë një plan veprimi të mirqënë për të përmirësuar arsimin parauniversitar aq sa i takon Bashkisë

Elbasan në kompetencat e saj. Për këtë plan ka patur konsultim publik dhe ka marrë miratimin edhe të anëtarëve të komisionit të arsimit. Ftoj këshilltarët që ta votojnë. Nëse ka ndonjë pyetje tja drejtojmë përfaqseses së Bashkisë e cila ka drejtuar grupin e punës së ngritur për këtë rast.

### **Rudina Mita-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pyetja ime është kjo: Cilat janë masat konkrete që Bashkia Elbasan ka parashikuar në planin vendor për arsimin parauniversitar, në lidhje me mbështetjen për orientimin drejt karrierës në këtë nivel arsimor? E dyta, nëse po, çfarë mekanizmesh janë parashikuar nga bashkia për të ndihmuar nxënësit për identifikimin e aftësive dhe interesave të tyre profesionale? Dhe e treta, a janë përfshirë prindërit, nxënësit dhe komuniteti në hartimin e politikave arsimore në nivel vendor?

### **Jonida Cungu-Përfaqesuese e Administratës**

Ky plan është hartuar duke u mbështetur vetëm te kompetencat ligjore që bashkia ka si institucion përballë gjithë Institucioneve Arsimore dhe Arsimit Parauniversitar në tërësi. Përsa I përket pyetjes së parë për masat konkrete në lidhje me mbështetjen për orientimin në karrierë unë ju orientoj dhe ju sugjeroj që të lexoni ligjin e arsimit parauniversitar ku kjo e drejtë I takon ministrisë. Megjithatë edhe për ti ardhur në ndihmë pikërisht orientimit dhe këshillimit në karrierë, ne kemi parashikuar dhe kemi planifikuar një mbështetje për shkollat profesionale me qëllim që institucioni I bashkisë të marrë përsipër pikërisht orientimin e nxënësve për tju drejtuar arsimit profesional.

Përsa I përket pyetjes së dyte, po kemi marrë parasysh dhe kemi parashikuar pikërisht për arsimin profesional, sepse arsimi I mesëm dhe arsimi nëntëvjeçar janë ekskluzivitet I Ministrisë së Arsimit. Përsa I përket pranisë së nxënësve dhe prindërve në këtë plan, plani ka më shumë se 20 ditë që është për konsultim publik në faqen zyrtare të bashkisë. Ne na janë drejtuar disa email-e nga shoqata të ndryshme dhe nga grupet e interesit, të cilët kanë sugjeruar përfshirjen e tyre në veprimtari të ndryshme të cilat ne I kemi planifikuar. Për rrjedhojë këtyre individëve I është kthyer përgjigje zyrtare për çfarë ne kemi pranuar dhe kemi shtuar sugjerimet e tyre.

### **Afrim Qosja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Në vijim të përgjigjes që dha Znj.Jonida unë për pjesën e edukimit të karrierës do tju informoja që duke qenë se I përkas dhe arsimit, që nga viti I kaluar shkollor pra në grup shkollor rreth 600 nxënës ka një kordinator të këshillimit të karrierës. Ata që janë arsimtarë këtu e dinë. Ka një pozicion të ri në stafet mësimore që është kordinatori I këshillimit të karrierës. Shkollat nëntë vjeçare e kanë veç dhe shkollat e mesme e kanë veç. Ka një program të caktuar nga ministria, japin llogaridhënie sipas institucioneve përkatëse, pra kjo pjesë nuk I takon bashkisë. Shumë nga aktivitetet që janë organizuar janë organizuar në bashkëpunim me bashkinë.

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Meqë jemi te kjo, nuk e kisha pikërisht për planin por meqë jemi te arsimi do ti uroj në rradhë të parë të gjithë nxënësve që ulen në bankat e shkollës në datën 8, një vit të mbarë arsimi dhe duhet ti tërheq pak veshin bashkisë që të jetë më e vëmëndshme ndaj kushteve dhe situatës që është alarmante në disa shkolla. Jo më larg se një orë më parë është bër një denoncim publik nga një portal në Shkollën Fadil Gurmani nëntë vjeçare në Elbasan, situata është alarmante përse I përket bankave, mureve me lagështi. Jo ambjenteve të jashtme se ato sipas denoncimit janë të rikonstruktura madje thotë edhe që e ka inaguruar Kryeministri por gjendja e brendshme është alarmante. Përderisa është në shkollën nëntë vjeçare I bie që është arsimi parauniversitar që është përgjegjësi e Bashkisë që të kujdeset për mbarëvajtjen e vitit shkollor, kushtet që duhet ti ofrohen fëmijve për mos kaluar te ngrohja që në shumë shkolla nuk funksionon në dimër. Një vëmëndje, merrni parasysh që ky denoncim që ju ka ardhur.... do ta shikoni këtë denoncim te Shkolla Fadil Gurmani

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Në fakt ne kemi parashikuar dhe punuar mjaftueshëm për këshillimin e karrierës. Ti përgjigjem Znj.Mita. Në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit kemi ndërmarrë një sërë masash sidomos për informimin e nxënësve për universitetet, për degët që ato kanë, janë bërë orë të hapura ku dhe në Universitetin e Elbasanit nxënësit kanë shkuar, janë njohur dhe janë informuar. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me këshillat e prindërve dhe me vetë shkollat për të patur një orientim më të

mirë të nxënësve. Qëllimi jonë është që ti mbajmë në Universitetin e Elbasanit, ky është qëllimi jonë por gjithsecili do zgjedhi degën e vet dhe ne I mbështesim totalisht. Ajo që në fakt është një shqetësim I drejtë I të gjithë prindërve është mësuesi I cili do të vihet kujdestar. I kemi kushtuar vëmendje të veçantë aftësive të ndryshme që kanë fëmijë të ndryshëm për vazhdimin e shkollave. Dhe patjetër që janë orientuar për shkollat, informacionin sot e kanë të plotë, e kanë patur se një pjesë janë regjistruar në Universitete dhe hapen ciklet e tjera të regjistrimit për nxënësit e klasave të trembëdhjeta dhe patjetër që ka një vëmendje të veçantë nga ne për të pasur një bashkëpunim të mirë për Universitetin e Elbasanit, degët që ofrohen aty, me Universitetet e tjera por dhe profilizimit të nxënësve që ata ta kuptojnë më mirë. Për këtë ne tek godina e cila po rikonstruktohet në kalanë e Elbasanit, njëri nga ambientet në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit do të jetë pikërisht për këshillimin e karrierës. Sot teknologjia ka ecur shumë, jemi duke diskutuar edhe me një universitet tjetër I cili ka futur një program pilot me intiligjencë artificiale për të kuptuar më mirë apo për të orientuar nxënësit e viteve të treta për të pasur më shumë njohuri mbi degët që ata duhet të vazhdojnë apo për të zënë disa boshllëqe që kanë. Po I shohim të gjitha mundësitë që në vazhdim të kemi një qasje sa më positive ndaj nxënësve për të patur një formim sa më të mirë e për ti shërbyer sa më mirë edhe ekonomisë së vendit. Përsa I përket Shkollës Fadil Gurmani është një shkollë totalisht e rikonstruktuar. Unë e shikoj që juve ju bëhet më mirë të shikoni një dy tre denoncime aty, dy tre gjëra, nuk e di çfarë ju intereson. E kuptoj shumë mirë atë pjesë, dhe pjesën e protagonizmit që duhet të merrni por ju ftoj të shkoni tek Shkolla Fadil Gurmani ta shihni dhe pastaj të flisni. Aty ka patur një problematikë përsa I përket bankave të shkollës, jo ambjentëve. Ambjentet janë totalisht të konstruktura me investimin e Bashkisë Elbasanit të miratuar po nga ky Këshill Bashkiak. Ka patur një mosrakordim përsa I përket investimit të cilit zakonisht për bankat e bën Ministria e Arsimit, është zgjidhur dhe po zgjidhet për të gjetur mundësi të tjera. Nëse nuk do të arrijmë dot që të gjejmë banka të reja, do të vijmë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të ardhshëm për të parashikuar bankat për Shkollën Fadil Gurmani. Deri tani kemi gjetur banka të mira të cilat do ti shërbejnë shkollës.

### **Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Duke qenë se jemi në fund të 2025 pra presim të miratojmë projektin e ri. Jam shumë e qartë Znj. Jonida mbi planin dhe nuk kam asnjë vërejtje në lidhje me këtë.

Sugjerimi im është se çdo plan që të veprojë në mënyrë efikënte do buxhet. Unë po ndalem vetëm te prioritetet dhe prioriteti I parë është investimi dhe përmirësimi I infrastrukturës. A do ketë një fond shtesë arsimit? A do përfshihet në plan në buxhetin e vitit 2026, një rritje e përqindjes së të ardhurave të këtij sektori sepse asnjë plan nuk mund të realizohet pa një buxhet të mirfilltë përkatës. Dua ta pranojmë Z. Kryetar që buxheti për arsimin është në shifra të ulta. Përsa I përket strategjive, kto janë në përputhje me strategjitë kombëtare sepse integrimi I shtresave të marxhinalizuara Rome Egjiptiane etj janë strategji kombëtare të cilët çdo institucion parauniversitar është I detyruar me ligj ta zbatojë sepse është ligji për Arsimin Parauniversitar, ligji për Universitetet...kjo gjë dihet. Unë do doja të sugjeroj rritjen e buxhetit për arsimin që kjo të ndikojë në infrastrukturë, në rritjen e mësuesve të ndihmës. Qyteti ynë është djepi I arsimit dhe nuk do ta konceptoja dot që ne të renditeshim prapa bashkive të tjera sepse mendoj që ne duhet të jemi para-rojë për vet historikun e arsimit që ka ky qytet, përveç cilësinë e mësuesve të shkëlqyer që ka ky qytet dhe mendoj që fëmijët e Elbasanit e meritojnë këtë.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Faleminderit Znj. Balliu, ka një gjë të vërtetë që buxhetet tona për arsim kanë ardhur në rritje të vazhdueshme sidomos ju vetë I keni miratuar në fakt. Vjet është miratuar po I njëjti buxhet I rritur për investimet në arsim. Nuk duhet të harrojmë që sapo mbaroi Shkolla Fadil Gurmani rikonstruktuar nga ne, mbaroi Shkolla Jonuz Çarçiu e Treganit në bashkëfinancim me Bashkinë e Elbasanit, sapo fillojnë tre shkolla të tjera brenda ktij viti Shkolla Naim Frashëri, Dhaskal Todri dhe Shkolla e Shushicës. Gjithashtu kemi edhe pesë projekte të tjera të cilat janë të përfunduara dhe presim të financojmë. Është hera e parë që Elbasani po rikonstrukton paralelisht kaq shumë infrastruktura shkollore. Sapo po përfundojmë çerdhen nr 2 rikonstruksion total I saj, sapo kemi përfunduar një sërë investimesh të tjera pjesore nëpër shkolla dhe po bëhemi gati për vitin arsimor. Jemi në vazhdim të ndërtimit të çerdhes nr 5 e cila është tek ish zyrat e Aluizmit dhe realisht fondi për arsimin dhe sportin ka ardhur gjatë gjithë kohës në rritje. Nuk është asnjëherë I mjaftueshëm, gati 130 struktura arsimore të cilat kërkojnë përveç mirmbajtjes së zakonshme dhe një fondi të posaçëm kryesisht për shkak të amortizimit që ka ndër vite, kërkojnë edhe investime të plota sidomos shkollat e qytetit dhe shkollat e njërive administrative të cilat janë me volum të madh që kërkojnë investime radikale. Për këtë po punojmë në vazhdimësi.Faleminderit!

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Një pyetje kisha për kryetarin-Rikonstruksioni I Shkollës Dhaskal Todri do fillojë këtë vit shkollor apo është spostuar?

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Jemi në procedura ligjore për prokurimin, ky vit shkollor do fillojë tek Dhaskal Todri aty ku është godina e vjetër. Brenda këtij viti pastaj do spostohen tek Shkolla Kostandin Kristoforidhi.

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Edhe një shqetësim tjetër kisha sepse ju përmëndët rikonstruksionin e çerdhes që është realizuar me sukses në opinion tim, çerdhja vazhdon të jetë tek godina e kopshtit tek Gurabardhi dhe ka shqetësim prindëror për spostimin e çerdhes sepse infrastruktura e brendshme nuk është plotësuar çerdhja. Ka një afat për këtë?

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Janë duke ardhur nga Turqia materiale të reja, ka ardhur një pjesë e tyre, janë vendosur kondicionerët, janë vendosur për fëmijët për neonatet të gjithë pjesa e infrastrukturës që duhet për ato me lisharset e vogla, me krevatet e vegjël. Po presim të na vijnë krevatet për grupet pak më të mëdha dhe besoj që brenda këtij 15 ditëshi të parë do të kenë ardhur e gjithë infrastruktura.

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

#### ***9. Për miratimin e “Kodit të Sjelljes 2025, nga Bashkia Elbasan”***

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju kërkoj ndjesë kur kam kaluar tek pika 10 kam harruar pikën 9 Kodin e Sjelljes, jeni të lutur ta votojmë. Ishte në bazën e asaj që u diskutua por duhet votuar veç.

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, 1 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

(B. Çopja; A. Kana; A. Meçja; E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 11 e rendit të ditës**

*11. Mbi akordimin e një fondi nga Bashkia Elbasan për Bashkinë Gramsh , për përballimin e pasojave të zjarreve të ndodhura në muajin Gusht 2025.*

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Bashkia Elbasan ka planifikuar 3 milion lekë të reja, keni nevojë për ndonjë diskutim?

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(D.Madhi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 12 e rendit të ditës**

*12. Mbi shpronësimin e hapsirave private më konkretisht holli qëndror I Teatrit Skampa nga bashkëpronarët e pasurisë ose të tretë të cilëve u përket pasuria.*

#### **Erki – Jurist I Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sporteve**

Ky material ka të bëjë me godinën e Teatrit Skampa e cila aktualisht është në bashkëpronësi nga Bashkia që shfrytëzohet, zhvillon aktivitetin e saj teatri dhe pjesa tjetër nga bashkëpronarët si një bar kafe. Marr shkak nga një akt raportim I shërbimit zjarrfikës I cili thekson mungesën e kushteve të sigurtisë dhe nga dëshira për të zhvilluar aty një formë muzeumi, lind nevoja për lirin e këtyre hapsirave. Dhe këto janë dy arsye kryesore që çojmë kërkesën për lirin e hapsirës nga bashkëpronarët kundrejt një tarife të përcaktuar nga një vendim gjykatë.

#### **Arben Hoxha-Përfaqësues I Administratës**

Problemi I bashkëpronësisë së teatrit është përcaktuar me vendim komisioni të pronave ktu e 30 vjet përpara. Pra duke konsideruar investimet që ishin bërë dhe pjesën që ishte e pronarit e shpronësuar pas viteve 40, komisioni duke patur parasysh amortizimin e pjesës vjetër dhe investimet e bëra nga shteti, ka përcaktuar një raport bashkëpronësie që I kalonte 20 %, çka do të thotë që ligji parashikonte që kur pjesa e pronarit është mbi 20% ngelet në bashkëpronësi. Dhe kështu ka funksionuar, duke qenë se dikur para 25 vjetësh kanë kërkuar pronarët që ti paguanin diçka për përdorimin e sendit të përbashkët siç përcakton kodi civil që ai që përdor sendin duhet që të paguajë tjetrin. Bashkia në fakt nuk I dha gjë atëherë dhe e kërkuan në rrugë gjyqësore, gjykata vendosi për 780 e ca dollar se atëherë flitej me

dollar te akti që përcaktonin qeratë. Në kushtet kur Bashkia nuk kishte mundësi për tja dhënë se bëhet fjalë për vitin 2000-2002, hapi dhe një kompromis me bashkëpronarët e tjerë që atyre tu lihej hapsira e hollit të teatrit për ta përdor ato vetë, dhe ndërkohë të hiqnin dorë sepse e kërkuan me përmbarim atë vjeljen, të hiqnin dorë nga kërkesa në përmbarim për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Më pas ky vendim gjykate mbi ankimin tonë, gjykata e lartë e ktheu pasi kishte marrë formë të prerë, e ktheu për rigjykim në Elbasan dhe Gjykata e Elbasanit ka vendos në 2005 që Ministria e Kulturës duhet të ishte ajo që të paguante pronarin për 3 vite deri në vitin 2000 kur me ligjin e pushtetit vendor teatri kaloi në pronësi të Bashkisë dhe pastaj për vitet e tjera në momentin që bëhej gjyqi do ta paguante Bashkia. Përcaktimi i kësaj vlere u bë mbas një ekspertize që mori gjykata që e ka caktu vlerën 108.000 lekë në muaj si pjesë që i takonte 30% që kishin bashkëpronarët e shumzuar për muajt dhe për vitet dhe doli ajo shumë që foli për Ministrinë dhe për Bashkinë. Duke qenë se Bashkia në vitin 2005 kur zhvillohej ky gjyq, Bashkia e kishte të lidhur marrëveshjen me bashkëpronarët nuk vendosi gjykata pagesë periodike më për Bashkinë sepse bashkia e kishte zgjidhur këtë problem. Dhe kështu kemi vazhduar deri ditët e sotme kur teatri për nevojat e veta kërkon ta ndryshojë këtë raport dhe ne kemi parashikuar aty që të paguajmë atë masë që ka vlerësuar gjykata, që ka bërë vlersimin e vet po themi për 2 vjet për Bashkinë dhe 3 vjet për Ministrinë duke iu referuar një vlere po themi 108.000 lekë, atë detyrohemi tja paguajmë bashkëpronarëve të tjerë për përdorimin që ne vetëm do ti bëjmë sendit. Arsyet i foli Zotëria pak më përpara.

### **Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ditën që ne zhvilluam komisionet, unë kërkoja një informacion të detajuar nga Administrata e Bashkisë në lidhje me aktin e pronësisë së hollit të Teatrit Skampa pra me nominativët e bashkëpronarëve dhe gjithashtu kërkoja dhe 2 vendimet e gjykatave në të cilat juve bazoheni dhe sot vini përpara nesh dhe bëni këtë kërkesë. Ky material akoma nuk ka ardhur dhe është e disata herë që unë bëj këtë kërkesë transparenca dhe korrektesa përballë këshillit duhet të jetë prioritare për atë kohë sa me dëshirën më të madhe sot ju votova dhe kodin e sjelljes integritetit etikës sociale etj. Shikoj pika 12 e rendit të ditës thotë mbi shpronësimin e hapsirave private më konkretisht holli qëndror i Teatrit Skampa. Në relacionin që keni sjellur thoni; Përsa më sipër Drejtoria e Artit dhe Kulturës kërkon që bashkëpronarëve tu paguhet vlera për përdorimin e godinës. Ktu ka shumë jurist, ktu ka një gabim

material apo është I qëllimshëm sepse shkresa e rendit të ditës thotë shpronësim dhe ktu thotë përdorim. Sepse ndryshojnë raportet në shpronësim dhe në përdorim. Pyetja e dytë lidhet me faktin se pse ka një urgjencë kaq të madhe për kalimin e ktij asemi në duart e Bashkisë Elbasan. Dimë që do ketë një rikonstruksion total të teatrit apo jo?Një rikonstruksion I cili teorikisht duhet të jetë përfshirë edhe në planin rregullator vendor për rregullimin e territorit që ne në parim e kemi miratuar vjet por sot pas një viti e tre muajsh akoma nuk e kemi përpara syve të konkretizuar.Nuk e dimë se çfarë do bëni, nuk e dimë si do të ndodhi kjo?Mos vallë ky nxitimi sot lidhet me realizimin e ktij plani që ne akoma nuk e kemi marrë?

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Mesa shoh dhe unë në fakt duhet të jetë gabim në material.

### **Arben Hoxha-Përfaqësues I Administratës**

Pjesa e parë unë besoj se është një gabim materiali I drejtorisë që ka përgatit relacionin sepse për shpronësimin Këshilli Bashkiak e ka vendosur një muaj më përpara shpronësimin e pjesës dhe kanë nis procedurat për shpronësimin.Kjo është thjesht meqë po I heqin përdorimin që I kishin dhënë para 20 vitesh detyrohemi ti shpërblejmë tani për përdorimin që do I bëjmë deri në përfundim të shpronësimit përgjatë kësaj kohe.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Është bërë një gabim tek titulli, ndoshta është gabimi I drejtorisë përkatëse, I faqes së parë sepse kemi miratuar në mbledhjen e kaluar të Këshillit Bashkiak shpronësimin pra që Bashkia e Elbasanit të marrë 100% të Teatrit Skampa.Mbas një procedurë të gjatë që është bërë korrespondenca ndarjesh të regjistrimit të Teatrit se ka qenë I paregjistruar fizikisht në hipotekë.Pas regjistrimit pas ndarjes së pronarëve, një punë shumë të gjatë për regjistrimin e Teatrit dhe ndarjes së pronësisë, në mbledhjen e kaluar miratuar shpronësimin për efekt të rikonstruksionit që do ti vij Teatrit Skampa. Projekti që do ti vijë Teatrit Skampa ska lidhje me planin rregullues të qytetit, nuk do ti ngriem as kate, nuk do ti shtohet as ndonjë sallë tjetër, është rikonstruksioni I Teatrit Skampa aty ku është.Kemi patur një emergjencë të vazhdueshme për lirimin e hollit të Teatrit jo sot por të paktën prej kohësh një shqetësim për lirimin e Teatrit Skampa.Mbasi miratoi

procedurat e shpronësimit atëhere dhe morëm vendimin sot, paraqitëm sot para jush për lirim e hapsirës dhe pagimin e detyrimit deri në përfundimin e shpronësimit total dhe shfuqizimin e vendimit të vitit 2002 të Këshillit Bashkiak të asaj kohe dhe kompensimin financiar sipas vendimeve të gjykatës për ishpronarët deri në përfundimin total të procesit të shpronësimit. E kemi patur këtë shqetësim prej kohësh dhe nuk e kemi lënë asnjëherë mbas dore regjistrimin e Teatrit, pjesën e pronësisë, vendimet e gjykatës, korrespondencën me gjykatën apo institucionet e ndryshme, me Ministrinë e Kulturës dhe erdhi sot mbas miratimit të shpronësimit që u bë në mbledhjen e kaluar dhe prandaj ka ardhur sot si material. Sot I kemi mbyllur procedurat që e kemi një datë të vendimit të Këshillit Bashkiak për shpronësimin, një dosje të çuar në qeveri pranë agjensisë përkatëse për fillimin e procedurave për shpronësimin dhe jemi në një proces ligjor për shpronësimin dhe patjetër që derisa të mbyllet ky proces ligjor për shpronësimin jemi të gatshëm që të paguajmë vlerën e vendimit të gjykatës, vlerën financiare për ti krijuar Teatrit Skampa kushtet e nevojshme për të punuar edhe kushtet e sigurisë.

#### **Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo familje është shpronësuar njëherë në 1945. Ju Zoti Kryetar dhe një pjesë e Anëtarëve në sallë vijnë nga familjet e ish-pronarëve. Është plagë e shoqërisë Shqiptare që ne të gjithë e njohim, paratë e gjyshërve tuaj janë përdorur nga Shteti Shqiptar për shumë e shumë vjet. Pronarët kanë vdekur në varfëri të plotë. Ne do ta dëshironim me gjithë shpirt që ne të mos e përsërisim historinë dhe të ktheheshim sërish te shpronësimet e 1945. Kur e thua termin shpronësim tingëllon pak ashpër pra bëhet fjalë për shpronësim apo për kompesim të pronarëve për vlerën aktuale të asaj prone e cila në vetvete nuk përfshin vetëm objekt truall por ka vlerë historike, financiare sepse I ka sjell nga Italia ka akustikën më të mirë në Ballkan ai Teatër dhe është pikërisht investimi I Z.Xhevit Biçaku. Prandaj ju lutem mos i kthehemi edhe njëherë një historie që duhet ta varrosim njëherë e mirë. Po ju drejtohem të gjithë juve si ish pronarë të cilët ende nuk I kanë marrë pronat e tyre, enden gjyqeve për pronat e tyre. Do doja që në këtë rast Bashkia të ishte e drejtë sepse boll padrejtësi I është bërë asaj familje për 45 vjet me rradhë.

#### **Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Doja të cilsoja diçka të rëndësishme që mbi të gjitha ne po flasim për Teatrin Skampa që të themi është nga Institucionet e vetme që na kanë ngelur, të rëndësishë

kulturore që kemi për qytetin. Në vend që Bashkia të merrej fillimisht me fasadën që lë për të dëshiruar, ne po flasim sot për shpronësimin. Kur personat që e kanë në pronësi ja kanë falur këtë godinë qytetit të Elbasanit, pse duhet të fillojmë tani ne me shpronësimin? Është bashkëpronësi por nuk e ka ndërtuar Bashkia, është një ndërtim i filluar që në vitin 1935 me financim, jo nga persona. Unë dua të di mbi çfarë baza ligjore fillohet ky shpronësim dhe çfarë të mire na sjell ne ky shpronësim? Çfarë plani ka për këtë shpronësim? Se mos ndodh që ka disa mënyra të tjera, mendohet si shpronësim dhe më pas meren dhe ndodhin ndryshime mbi një objekt të rëndësishë kulturore të Elbasanit .

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Spo e kuptoj fare qendrimin të jem i sinqertë sepse edhe kur flet për Teatrin Skampa si një monument i cili është një vlerë, është një monument kulture i një kategorie të caktuar i cili ruhet nga shteti. Për ne është shtëpia e artit, e teatrit, e kulturës, ka një vlerë të caktuar. Shpronësimi i asaj, kështu është termi ligjor pastaj mund ta quajmë si të duam. Ne nuk mund të bënim investim në Teatrin Skampa, vetëm me lekët e jona kur është në bashkëpronësi sepse automatikisht i ngrejmë me lekët tona vlerën një prone e cila është në bashkëpronësi, pa investuar dhe pala tjetër. Kjo është A-ja e kodit civil. Për ti hapur rrugën dhe investimit që ne do bëjmë në Teatrin Skampa, duhen mbyllur njëherë procedurat ligjore që të bëhet shpronësimi i godinës, kompesimi përkatës financiar i familjarëve dhe pastaj të vazhdohet me investimin e godinës. Sot nuk jemi në këtë pikë, ajo ka kaluar si fazë muajin që kaloi dhe sot ne jemi për lirimin e hollit të teatrit pavarësisht se në titullin e materialit është bërë një gabim nga drejtoria përkatëse. Sot është vetëm për lirimin e hapsirës dhe për prishjen e një vendimi të Këshillit Bashkiak të vitit 2002, ku ky holl i teatrit kur Bashkia Elbasanit nuk ka patur financa dhe nuk kishte mundësi financiare që ti paguante ish pronarët, i ka lënë në përdorim pa afat derisa të kryhet procesi i shpronësimit, hollin e Teatrit Skampa. Sot për shumë arsye ne jemi të gatshëm si Bashki që këtë vlerë financiare të caktuar tja paguajmë ne për të rritur kushtet e sigurisë në Teatër, për të patur një ambjent sa më dinjitoz . Ju kemi parashtruar për të prishur vendimin e vitit 2002, ne vlerën financiare të përcaktuar në vendimin e gjykatës tja kompesojmë ne si Bashki dhe hollin e Teatrit të lirohet duke iu ardhur në shërbim qytetarëve dhe përdoruesve të Teatrit Skampa, atyre që realisht e përdorin për art dhe kulturë Teatrin.

### **Eva Bica-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kryetari I tha ato që unë do të thoja kështu që nuk kam pse I përforcoj.

### **Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Zoti Biçaku është I biri I Fuat Biçakut që ka qenë themelues I Shtetit Shqipëtar, pasi e konfiskuan e futën dhe në burg 20 vjet. Ajo që më shqetëson mua ka që në 1944 njëlloj komunikimi Bolshevik majtas dhe djathtas. Ka nis me ligjin 7501 dha vazhdon dhe sot. Po them këtë që ky Zotëria është konfiskuar jo shpronësuar

### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Tek pjesa e shpërblimit për lirim e hollit, kam përshtypjen që po bëni një gabim të vogël , I referoheni vendimit të gjykatës të vitit 2002 mesa thatë, 2005 dhe nga 2005 e deri sot ka ndryshuar tregu, shikoni se mos ngrihen kta përdoruesit ju hedhin në gjyq prapë

### **Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

I nderuar Kryetar po marr shkas të them fjalën time dhe pas ndërhyrjes tuaj. E para u pranua që si material ka ardhur gabim pra nuk kemi shpronësim të hapsirave dhe e dyta nuk mundem të rri pa e thënë se si erdhëm këtu pasi Kryetari I Bashkisë minimalisht tre herë e ka përmend që muajin që kaloi kaluam një vendim në parim për fillimin e procedurave me bashkëpronarët e Teatrit Skampa. Është e vërtetë që e morëm këtë por mbasi morëm informacione të rreme nga përfaqësuesit tuaj Kryetar. Personalisht në mbledhjen e komisioneve kam kërkuar paraqitjen e bashkëpronarëve dhe nëse është e mundur që të dëgjohet edhe fjala e atyre, dhe më është thënë që nuk I gjejmë bashkëpronarët .Unë personalisht nuk e dija lidhjen që ka Bashkia me një biznes privat, sot po e mësoj. Jam shumë I qartë, e keni dhe në proces verbal që zonjusha që e mbrojti materialin për kalimin në parim të shpronësimit na ka thënë që pjestarët e katër familjeve nuk gjinden , edhe në mbledhje të Këshillit na është dhënë po ky informacion dhe e keni të cituar nga unë ;Do ju lutesha të bëhen publikë emrat e familjarëve që janë bashkëpronarë sepse nga informacioni që morëm nuk është paraqitur asnjë familjar. Pra këmbëngulte që ne nuk I gjejmë kto familjarë ndërkohë që ju qenkeni në një marrëdhënie me familjarët, me bashkëpronarët, qenkeni në një marrëdhënie prej shumë vitesh. Ky informacion na është dhënë, ngul këmbë, e miratuam në fillim fare te rendi muajit

që kaloi. Pra informacioni që na është dhënë është ky, nuk ka dhe nuk po na vijnë bashkëpronarët .

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Zonja Arba Zamirit konkretisht ja ka vënë në dispozicion.

### **Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mbaj përgjegjësi për kto që po deklaroj tani. Është mbrojtur nga Zonjusha e Bashkisë që paraqiti materialin që familjarët nuk na paraqiten, nuk I dimë se ku janë familjarët madje I kërkoja tapinë që ta shpërndanim misid nesh që të kërkonim se kush janë pasardhësit e familjarëve. Në mbledhje të këshillit përsëri jak am kërkuar Zonjës dhe përsëri të njëjtin informacion ka dhënë që nuk vijnë bashkëpronarët. Nuk ka bashkëpronarë, bashkëpronarët janë nipat dhe mbesat e nuk dihet se ku janë. Ktë jak am kërkuar dhe I kam thënë bëje publike, ngulte këmbë zonja ndërkohë që ju qenkeni në një marrdhënie prek kaq vitesh me nontratë me bashkëpronarët. Ky informacion na ka ardhur nga ju. E para për materialin që kaloi një muaj më përpara, e dyta gabimin e thashë. Jam dakort unë, projekt-vendimi duhet të fillonte me Bashkia duhet të njoftojë dhe të marri masat për shpërblimin e tyre, dhe jo ne të vendoskemi sot që nesër ambjenti I Teatrit Skampa të lirohet dhe të zhduket ai robi, nuk e di kush është ai, kto janë punët e juaja pastaj. Dëmshpërbleni njerëzit nëse I keni hyrë në hak dhe hajdeni marrim një vendim pastaj që duhet të rrinë apo duhet të ikin apo si vendime gjykate nëse do keni nesër pasnesër përballje me gjykatën me zotërinjtë. Pra për pikën 1 nuk jam absolutisht dakort që ta kaloj, unë vet si person nuk e kaloj dot, ambjentet e hollit të teatrit të lirohen dhe të përdoren për funksionimin e teatrit.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Një sqarim në momentin që kemi dalë nga komisioni Zamirit nga Zonja Arba I janë vënë në dispozicion tapia me emrin e pronarëve. I kërkoje I more.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Se kuptoj gjithë këtë pjesë që të kanë mashtruar ...kur ka një procedurë ligjore që aplikohet në të gjitha rastet dhe jam I bindur që dhe drejtoresha që e ka mbrojtur atë material, që prej shumë vitesh është drejtoreshë prej shumë kohësh, të ketë bërë gabime të tilla sa të thotë e njoh unë këtë apo se njoh unë atë. Ka një procedurë

ligjore që zbatohet dhe për këtë procedurë ligjore është bërë me shpallje në media, në shpalljen e bashkisë pra ka forma të caktuara, nuk del drejtori I drejtorise në Bashkinë e Elbasanit të vejë tellallin dhe as të kapi njerëzit prej xhakete. Ajo ka thënë procedurën siç ka ndjekur procedurën ligjore me korrektësi. As këshilltarëve nuk mund ti thotë një gjë të pavërtetë, kur ajo bën një procedurë ligjore dhe bën shpalljen përkatëse dhe janë trashëgimtarët të cilët duhet të vijnë dhe të regjistrojnë pronën, të ndajnë e të tjera dhe kur svjen njeri nuk mund të gënjejë dhe të thotë që I kam marrë unë në telefon personat sepse nuk e ka për kompetencë. Ka një procedurë ligjore që ndjek dhe ajo ka ndjekur këtë procedurë ligjore. Unë besoj se ka qenë korrekte të kjo procedurë ligjore. Nëse ju keni dyshime që dikush ju ka mashtruar apo ju ka sjellë materiale të pavërteta patjetër që mund ti drejtoheni organeve kompetente por është e rëndë ajo që thuhet që të ka mashtruar në sjelljen e materialeve. Kur thjesht flet një diçka dhe ai personi që e ka thënë atë e ka një barrë administrative minimalisht mbi kurriz. Faleminderit!

#### **Zamir Muzhaqi – Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju kuptoj shumë mirë dhe unë gjatë momentit që po flisja jua thashë mbaj përgjegjësi për fjalët e mia.Kam kërku po të njëjtën gjë thirrjen e 5 emrave dhe më është thënë nuk ka njerëz.

#### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Po si nuk ka njerëz, atë nuk ta thotë dot njeri ty që ska pasardhës se janë 5 familjet më të mëdha të Elbasanit. Kush ta ka thënë që nuk kanë pasardhës ato?Sbesoj ta kan thënë këtë.Ta ka thënë dikush këtë? Kur e ke procedurë ligjore që ti dëgjosh ato?Kur I ke dëgjuar herë tjetër bashkëpronarët,për shpronësimet, për rrugët, për investimet që janë bërë?Asnjëherë.

#### **Lumturi Hasa-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë jam pro zhvillimit të teatrit sepse siç e dini është godinë historike në qytetin tonë por lind pyetja mos është e njëjta skemë si e Teatrit Kombëtar ku është dora e Kryeministrit për të ngritur kulla?

#### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Jo nuk është.Teatri Skampa do jetë Teatri Skampa, do rikonstruktohet, ka një projekt për rikonstrukcionin, është një monument kulture që do rikonstruktohet

ashtu siç është.Mbasi të mbarohet gjithë procedura ligjore e shpronësimit dhe ne të kemi vën buxhetin përkatës, ne si Bashki e Elbasanit apo të gjejmë ndihmën e ministrisë por teatri është teatër nuk do ti ndodhi absolutisht asnjë gjë dhe këtë ta siguroj.

**Lumturi Hasa-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**


Një qytet pa teatër është pa zë .

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro,10 kundër, - abstënim, miraton sa më sipër.

(Y.Balliu;V.Balliu;B.Çopja;L.Hasa;A.Kana;D.Madhi;A.Meçja;E.Murataj;E.Muzhaqi;Z.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

#### **Pika 13 e rendit të ditës**

*13. Për miratimin e kryerjes së studimit të potencialit të erërave, me synim ndërtimin e parqeve Eolike në Bashkinë Elbasan (Zona Labinotit)*

#### Shpëtim Çullhaj-Përfaqësues I Administratës

Një subject ka sjellë kërkesën për të bërë studim në Zonën e Labinot Malit për të kryer studim për matjen e potencialit të erërave me synim ndërtimin e parqeve Eolike. Ky subject do të vendosi për matje dy kulla të cilat zenë një sipërfaqe 1.4 hektarë që do të kryejë studimin. Këto janë me struktura alumini të çmontueshme.


Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 2 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(D. Madhi; E. Murataj)

(D. Çepa)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika 14 e rendit të ditës**

#### ***14. Mbi dorëhejen e Anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Luan Rama***

### **Luan Rama - Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju falenderoj për bashkëpunimin që kemi patur deri tani, ju uroj suksese dhe ta gëzoni sallën e re. Një falenderim për Kryetarin që më ka besuar detyrën e re si Administrator në Rajonin Nr 6. Falenderim të veçantë dhe për strukturat e partisë socialiste që dhanë edhe ato mbështetjen për mua. Faleminderit!

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, 1 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.09.2025, ora 13:18 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e Bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

**Pika 15 e rendit të ditës**

#### ***15. Mbi lirimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani***

### **Sokol Sinani-Sekretar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Të nderuar këshilltarë, I nderuar Z. kryetar, unë sot jap dorëheqjen nga pozicioni I sekretarit të këshillit për arsye të marrjes së një detyre të re. Ju falenderoj shumë për bashkëpunimin dhe besimin që më keni dhënë. Unë do jem bashkëpunues edhe në pozicionin tjetër. Ju falenderoj shumë të gjithëve!

### **Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Sokoli merr një detyrë tjetër së shpejti, e kemi patur edhe antarë këshilli. Faleminderit Sokol për kontributin tuaj dhe suksese në detyrën e re!

Mbledhja përfundon në orën 15:35

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro,- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

